



**VENDIM**

**Nr. 32, Datë 09.03.2016**

**MBI**

**FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENSIMIN E SHOQËRISË  
“SKATINA HEC”SH.P.K., NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË  
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC  
“SKATINA” ME FUQI TË INSTALUAR 2677 KW**

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2 gërma “a” dhe 110 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, neneve 4, pika 1, gërma “a”; 5, pika 1 gërma “a”; 10 pika 3 të “Rregullores për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, Nr. 108, datë 09.09.2008 dhe nenit 18 pika 1 gërma “a” e Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21 datë 18.03.2009, te ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 09.03.2016, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “SKATINA HEC” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut për liçensimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie nga Hec “SKATINA”,

**Konstatoi se :**

Aplikimi i shoqërisë “SKATINA HEC” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni tekniko- ekonomik (neni 9, pikat 4.1.1; 4.1.2; 4.1.3; 4.1.4 dhe 4.1.5), është plotësuar në mënyrë korrekte.

**Për mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:**

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3)
- Dokumentacioni teknik dhe grafik (Neni 9, pika 4.1.3)
- Leje nga institucione te tjera ( Neni 9, pika 4.1.5 )

do të njoftohet subjekti që në bazë të “Rregullores për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/të Pjesëshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, t`i paraqesë këto në ERE, brenda afateve të përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “SKATINA HEC” sh.p.k., për liçensim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Skatine” me fuqi 2677 KW.
2. Drejtoria e Liçensimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Liçensuarve të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë  
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.